



Datë: 02.09.2025
Numër Protokolli: 6226/2025

A.nr.1289/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, si dhe Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.1289/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesi M.A, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafët 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 02.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1289/2025, e datës 03.07.2025, e parashtruar nga ankuesi M.A.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, M.A (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 03.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit për kompensimin financiar-diferencës në pagë, të datës 25.06.2025 nga Zyra e Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje MPJD), ndërsa, kjo e fundit, më datë 17.07.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 5521/2025 të datës 15.08.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: *Kolegji i Këshillit*) ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4492/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin dhe plotësimin të datës 11.10.2019; Vendimin me Nr.Ref.41/2023 të datës 13.02.2023; Vendimin me Nr.Ref.65/2025 të datës 14.02.2025; Kërkesën e datës 30.04.2025; E-mailin e datës 25.05.2025; Qarkullimin bankar dhe dokumentin e identifikimit të ankuesit; Përgjigjen në ankesë të datës 17.07.2025; Akt emërimit me Nr.175/2025 të datës 18.02.2025; Listat e pagave të ankuesit; Vendimin

Ref.Nr.538/2022 të datës 13.09.2022; Vendimin Nr.Ref.1116/2021 të datës 16.02.2021; Vendimin Nr.ref.163/2023 të datës 06.02.2023.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Ndryshim dhe plotësimit të akt emërimit të datës 11.10.2019, ka qenë i punësuar fillimisht në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Tutje, Ministria e Ministrisë së Punë të Jashtme dhe Diasporës, përmes Vendimit me Nr.ref.1116/2021 të datës 16.02.2021, të njëjtin me Gradën Diplomatie Këshilltar, e ka caktuar të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje/Bullgari, ndërsa sipas Vendimit Ref.Nr.538/2022 të datës 13.09.2022, ankuesi është transferuar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tokio/Japoni, deri në nxjerrjen e Vendimit me Nr.Ref.163/2023 të datës 06.02.2023, përmes të cilit akt është shfuqizuar Vendimi Nr.Ref.538/2022 i datës 13.09.2022, ku si rrjedhojë ankuesi është tërhequr/kthyer nga Misioni, për nevojat e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Më tej, sipas Vendimit me Nr.Ref.41/2023 të datës 13.02.2023, të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, ankuesi është sistemuar përkohësisht në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Afrikën Nën Sahariane-Departamenti për Afrikë dhe Lindje të Mesme, ndërsa me Vendimin Nr.Ref.65/2025 të datës 14.02.2025, i njëjti është sistemuar në mënyrë të përhershme në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Afrikë dhe Lindje të Mesme, ashtu që më datë 18.02.2025, ankuesit i është lëshuar Akt emërimi me Nr.175/2025 për këtë pozitë.

Si rrjedhojë, ankuesi me datë 30.04.2025 ishte drejtuar me kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, për kompensimin financiar të diferencës së pagës nga pozita e Udhëheqësit të Divizionit dhe Drejtorit të Departamentit, dhe atë për periudhën dy (2) vjeçare, mbi bazën ligjore sipas 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës. Ndërsa, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, me e-mailin e datës 25.06.2025 ka njoftuar ankuesin se sipas rekomandimit të Zyrës Ligjore, kërkesa juaj nuk aprovet.

Ankuesi, më datë 03.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se me rastin e caktimit të tij nga pozita e Drejtorit të Departamentit në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit, përveç uljes në pozitë është dëmtuar edhe financiarisht, duke cenuar kështu pozitën e tij zyrtare dhe të drejtën financiare, si rrjedhojë ankuesi mbështetur në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, kërkon aprovimin e kompensimit financiar-diferencës në pagë për periudhën dy (2) vjeçare apo në total prej 24 muajsh.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publike, si ligj i aplikueshëm në kohën e sistemimit të përkohshëm të ankuesit, përkatësisht nenit 27, paragrafi 3, ku përcaktohet se: “3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil..”, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje LPPA) përkatësisht nenit 124, paragrafit 1 dhe nenit 127, paragrafet 1 dhe 4, ku përcaktohet se: **Neni 124 paragrafit 1.** Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim..., **Neni 127 paragrafi 1 dhe 4:** 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes

administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë ,,” dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor, e në mbështetje të provave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi së ankuesi ishte pajtuar me sistemimin e tij të përkohshëm dhe përkundër që Vendimi me Nr.Ref.41/2023, të datës 13.02.2023, ka përmbajtur këshillë juridike mbi të drejtën e ankesës në KPMSHCK, i njëjti nuk e kishte kontestuar këtë akt dhe së deri në sistemimin e tij në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Afrikë dhe Lindje të Mesme, nuk kishte parashtruar asnjë kërkesë të njësia përgjegjëse për sistemim në pozitë të nivelit të mesëm drejtues, pra, ankuesi deri më datë 30.04.2025, nuk ka ndërmarr asnjë veprim ndaj kundërshtimit të aktit për sistemimin e tij të përkohshëm nga pozita e nivelit të mesëm drejtues në atë të nivelit të ulët drejtues.

Ndërlidhur, me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të sipër theksuara të ankuesit, Kolegji i Këshillit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.08L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 22, i cili përcakton se: *Për orët e punës së kryer, zyrtarja/i publik ka të drejtën e pagës. Paga e zyrtares/it publik rregullohet me Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik.*; si dhe paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili përcakton se: *1.Sistemi i pagave i rregulluar me këtë ligj bazohet në parimet e mëposhtme: 1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit – nënkupton që secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin.*; rrjedhimisht konstatoj së e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën përkatëse duhet të realizojnë pagë të njëjtë, dhe se në rastin përkatës rezulton se janë respektuar këto dispozita ligjore ngase ankuesi ka realizuar pagën sipas pozitës që ka ushtruar atë të Udhëheqësit të Divizionit.

Andaj, mbi gjendjen e këtyre fakteve e duke u bazuar në nenin 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se *1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar*; Kolegji konstaton së meqenëse ankuesi brenda afatit ligjor nuk e ka kontestuar me mjet të rregullt juridik vendimin për sistemim të përkohshëm, atëherë, Vendimi me Nr.Ref.41/2023, i datës 13.02.2023, është bërë i ekzekutueshëm, kështu që, pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin financiar të diferencës së pagës në mes pozitës së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues është i pa bazuar, dhe se mbi këtë bazë dhe konstatimit të lartë theksuar, pretendimi i tij nuk gjen mbështetje ligjore.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1289/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi M.A;
- Organit të Punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të MPJD dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.